

Takimi i 5-të plenar i Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit

E mërkurë, 8 korrik 2015

Prishtinë, Kosovë

Konkluzionet e takimit

(1) Hyrje

Takimi i pestë plenar i Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit u mbajt të mërkurën, më 8 korrik 2015, në Prishtinë. Takimi u kryesua nga z. Bekim Çollaku, Ministër i Integritetit Evropian i Republikës së Kosovës, dhe z. Jean-Eric Paquet, Drejtor për Ballkanin Perëndimor i DP për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim në kuadër të Komisionit Evropian.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, theksoi rëndësinë e zhvillimeve të fundit në agjendën evropiane të Kosovës dhe procesin e saj të aderimit në BE si thelbësore për zhvillimin dhe prosperitetin e vendit. Kryeministri shprehu bindjen e fuqishme të institucioneve të Kosovës dhe qytetarëve të saj se Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) do të shërbejë si bazë për procesin e integritetit të vendit dhe mundësi për zhvillimin e tij ekonomik. Ai më tej theksoi rëndësinë e MSA-së për forcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë, stabilitetin dhe zhvillimin e saj politik dhe ekonomik, harmonizimin e legjislativës së saj me *acquis*-në, promovimin e bashkëpunimit rajonal, si dhe që Kosova të ndërtojë marrëdhënie të ngushta politike me institucionet e BE-së dhe me shtetet e saj anëtare veç e veç. Kryeministri Mustafa gjithashtu përsëriti përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për përmbylljen e suksesshme, sa më shpejt të jetë e mundur, të MSA-së dhe të procesit të liberalizimit të vizave.

Në fjalimin e tij hyrës, Drejtori Paquet theksoi rëndësinë e zhvillimeve të mëhershme dhe në vazhdim e sipër drejt nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për procesin e aderimit të Kosovës në BE, duke njoftuar se diskutimet me Shtetet Anëtare mbi tekstin e inicializuar të marrëveshjes janë në përfundim e sipër. Z. Paquet gjithashtu vuri në dukje se MSA do të jetë hap historik që do të hapë një fazë të re në marrëdhëniet BE-Kosovë, duke theksuar se është me rëndësi thelbësore që Kosova të jetë e gatshme kur marrëveshja të hyjë në fuqi vitin e ardhshëm. Në mënyrë më specifike, ai u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës që të ecin përpara sa i përket Gjykatës Speciale në mënyrë që të vazhdohet me angazhim konstruktiv në dialogun me Serbinë, dhe të ecet përpara me reformat në fushat e sundimit të ligjit, reformës së administratës publike, zhvillimit ekonomik dhe qeverisjes, si dhe në trajtimin e papunësisë.

(2) Çështjet politike dhe punët e brendshme

(a) Kuvendi: Emërimi i anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura

Z. Gëzim Kasapollari (Këshilltar Politik i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës) prezantoi zhvillimet dhe gjendjen aktuale sa i përket emërimit të anëtarëve të bordeve të atyre institucioneve të pavarura që bordet e të cilave nuk gjenden në përbërje të plotë. Z. Kasapollari nënvizoi emërimin e Avokatit të Popullit si arritjen më të rëndësishme në këtë drejtim. Ai gjithashtu vuri në dukje se nga 22 institucione të tilla, 12 janë identifikuar në

muajin maj 2014 si institucione me borde jo plotësisht funksionale, për shkak të skadimit të mandatit të disa apo të gjithë anëtarëve të tyre. Me qëllim të përfundimit të procedurave të emërimit, Kuvendi aktualisht është në pritje të propozimeve nga Qeveria për emërimin e anëtarëve të bordeve të tetë institucioneve të pavarura (Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Autoritetit të Aviacionit Civil, Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Agjencisë për Privatizim të Kosovës, Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm). Nga 13 bordet e institucioneve të pavarura për emërim e të cilëve është përgjegjës vetë Kuvendi, procedurat për emërimin anëtarëve të bordeve të tre prej këtyre institucioneve (Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, Gjykatës Kushtetuese dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës) janë në proces e sipër.

Z. Paquet shprehu shqetësimin e tij për vonesat e shkaktuara dhe theksoi rëndësinë e përfundimit të këtij procesi në kohën e duhur dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, si dhe me standardet e vendosura. Ai gjithashtu vuri në dukje rëndësinë e sigurimit të funksionimit të të gjitha institucioneve dhe agjencive të pavarura në mënyrë që Kosova të jetë e gatshme të përmbushë kriteret e procesit të anëtarësimit në BE, në përgjithësi, dhe për zbatimin e MSA-së, në veçanti.

Veprimet pasuese:

- Qeveria dhe Kuvendi të hartojnë një plan të hollësishëm, me afate të besueshme kohore, për të funksionalizuar plotësisht të gjitha institucionet e pavarura përmes përfundimit të të gjitha emërimeve të anëtarëve të bordeve (fillimi i shtatorit 2015);
- Qeveria dhe Kuvendi të sigurojnë emërimin e anëtarëve të bordeve të të gjitha institucioneve të pavarura (dhjetor 2015).

(b) Institucioni i Avokatit të Popullit: emërimi i Avokatit të Popullit dhe sigurimi i objektit të institucionit

Znj. Salihe Mustafa, Zëvendës-kryesuese e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, raportoi për emërimin nga ana e Kuvendit të z. Hilmi Jashari në postin e Avokatit të Popullit. Ajo gjithashtu theksoi rëndësinë e sigurimit të një objekti të përshtatshëm për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Megjithatë, ajo pranoi vështirësitë e arritjes së kësaj për shkak të vonesave në zgjidhjen e çështjes së objektit, dhe shprehu zotimin e Kuvendit që të intensifikojë përpjekjet për zgjidhjen e kësaj çështjeje, në bashkëpunim me Qeverinë. Z. Mahir Yağcılar, Ministër i Administratës Publike, gjithashtu shprehu angazhimin e qeverisë për zgjidhjen e kësaj çështjeje sa më shpejt të jetë e mundur, duke konfirmuar se janë duke u bërë përgatitje për dorëzimin e objektit aktual të Gjykatës Kushtetuese Institucionit të Avokatit të Popullit sapo që Gjykata Kushtetuese të zhvendoset në Pallatin e Drejtësisë.

Z. Paquet e mirëpriti emërimin e Avokatit të Popullit, duke shprehur gjithashtu rëndësinë që Komisioni i kushton funksionimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në mënyrë plotësisht të pavarur, si dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me këtë institucion. Ai gjithashtu i bëri thirrje Qeverisë që të zgjidhë çështjen e objektit të këtij institucioni para skadimit të kontratës së Institucionit të Avokatit të Popullit në objektin aktual (9 gusht). Ai bëri të qartë se zbatimi i ligjit të ri për Avokatin e Popullit, përfshirë kapacitetet e

këtij institucioni që të ushtrojë plotësisht mandatin e tij, është pjesë e kërkesave për liberalizimin e vizave.

Veprimet pasuese:

- Qeveria të sigurojë që Institucionit të Avokatit të Popullit t'i jepet objekt adekuat të nevojshëm për funksionimin e duhur të tij (në fillim muajit gusht 2015).

(c) Politikat kundër-korrupsionit: ligji mbi konfliktin e interesit

Z. Hajredin Kuçi, Ministri i Drejtësisë, prezantoi përparimet dhe gjendjen aktuale sa i përket plotësim-ndryshimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Ai vuri në dukje se amendamentet fokusohen në zgjerimin e fushëveprimit të këtij ligji në tërë sektorin publik, në daljen me një listë të ndalimit të aktiviteteve të punësimit në të cilat nëpunësve të sektorit publik do t'u ndalohej të përfshiheshin, si dhe në harmonizimin e mëtejshëm të këtij ligji me legjislacionin tjetër relevant.

Z. Paquet theksoi rëndësinë e harmonizimit të ligjit mbi konfliktin e interesit me Kodin Penal dhe tërë legjislacionin tjetër relevant. Ai duhet të mbulojë të nëpunësit e sektorit publik, përfshirë këshilltarët politikë. Z. Paquet gjithashtu përmendi nevojën që të kufizohet ushtrimi i funksioneve të shumëfishta nga ana e zyrtarëve publikë. Ai shprehu rëndësinë që Komisioni i kushton përmirësimeve të mëtejshme në fushën e politikave kundër-korrupsionit, në përgjithësi.

Veprimet pasuese:

- Qeveria dhe Kuvendi të kryejnë një analizë të hollësishme dhe të bëjnë një rishikim të tërësishëm të Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik në mënyrë që ta harmonizojnë atë me Kodin Penal dhe legjislacionin tjetër relevant. Konsultimet publike duhet të mbahen me qëllim që të adresohen shqetësimet e ngritura nga shoqëria civile, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe partnerët evropianë të Kosovës. Ky projektligj veçanërisht duhet të përcaktojë zyrtarët publikë në përputhje me standardet evropiane dhe të kufizojë ushtrimin e funksioneve të shumëfishta nga ana e zyrtarëve publikë (dhjetor 2015).

(d) Krimi financiar dhe konfiskimet: të arriturat konkrete dhe statistikat

Z. Shqipdon Fazliu, Koordinator Kombëtar kundër Krimit Ekonomik, prezantoi progresin e arritur gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 nga institucionet e zbatimit të ligjit dhe institucionet gjyqësore në luftën kundër krimit financiar dhe konfiskimit të pasurive të fituara nëpërmjet veprave penale. Ai raportoi se gjatë kësaj periudhe janë ngrirë dhe sekuestruar pasuri në 55 raste penale që janë duke u hetuar, me një vlerë të përafërt prej 16,123,010 EUR. Vlera e përafërt e pasurive kriminale të konfiskuara gjatë kësaj periudhe është 64,687.65 EUR. Z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit, dhe z. Enver Peci, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, raportuan mbi të arriturat konkrete në hetimin dhe ndjekjet penale kundër krimit ekonomik gjatë të njëjtës periudhë. Sipas të dhënave të prezantuara, në prokurori janë ngritur 148 kallëzime të reja penale (që përfshijnë 218 kryerës të dyshuar) dhe gjatë të njëjtës periudhë nga ana e tyre janë lëshuar 100 aktakuza. Numri i rasteve të krimit ekonomik në punë në gjykata, përfshirë rastet e trashëguara, ka arritur në gjithsej 545 (që përfshijnë 729 persona), ndërsa janë zgjidhur 149 raste (që përfshijnë 182 persona). Kryeprokurori i Shtetit gjithashtu

raportoi se janë sekuestruar dhe konfiskuar pasuri që arrijnë vlerën e përafërt prej 2.5 milionë EUR, respektivisht 5,000-6,000 EUR, gjatë vitit 2013.

Shefi i Njesisë së Komisionit Evropian për Kosovën, z. David Cullen, mirëpriti certifikimin e hetuesve financiarë që është bërë bashkërisht nga Policia e Kosovës, prokuroria, auditori i përgjithshëm, banka qendrore, doganat dhe NjIF. Ai shprehu njohjen e vlerës më të lartë të pasurive që menaxhohen nga agjencia përgjegjëse (AAPSK). Z. Cullen deklaroi se Kosova duhet të shtojë përpjekjet e saj që të vihen në zbatim mjetet për hetime financiare dhe konfiskimin e pasurive dhe të kryhen hetime të përbashkëta. Ekspertiza e Kosovës për të trajtuar hetimet komplekse penale, siç janë krimi financiar dhe mashtrimet në prokurim, është ende e kufizuar. Avancimi i ekspertizës në këtë fushë është i domosdoshëm për të trajtuar korrupsionin në mënyrë efektive.

Veprimet pasuese:

- Institucionet e zbatimit të ligjit dhe institucionet gjyqësore të sigurojnë që krimi financiar hetohet dhe ndiqet penalisht në mënyrë sistematike përmes një qasje të integruar në të gjitha rastet duke përdorur plotësisht hetuesit e certifikuar financiarë me qëllim që të rritet edhe më tej vlera e përgjithshme e pasurive të konfiskuara (dhjetor 2015);
- Institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore të vazhdojnë me ngritjen e mëtejme të kapaciteteve teknike e profesionale për parandalimin dhe luftimin e krimit financiar (dhjetor 2015);
- Institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore të përmirësojnë më tej mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore mbi krimin financiar (dhjetor 2015).

(3) Të drejtat e njeriut, sistemi i drejtësisë dhe gjyqësori

(a) Reformat në sistemin e drejtësisë: zbatimi i pakos së ligjeve për gjyqësorin

Z. Paquet mirëpriti miratimin e katër ligjeve të pakos së Gjyqësorit, siç është Ligji mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial, Gjykatat dhe Kryeprokurorin e Shtetit. Ai theksoi se miratimi i legjislacionit është vetëm pjesa e parë e ndryshimit të sistemit apo strukturës. Kosova duhet të fokusohet në zbatimin e duhur dhe rigorozë të këtyre ligjeve.

Përderisa z. Paquet ngriti shqetësimin për bazën ligjore të mandateve të disa anëtarëve të Këshillit Prokurorial (KPK), z. Lumezi theksoi nevojën për kuorum të domosdoshëm të KPK-së. Z. Lumezi shpjegoi se njërit prej anëtarëve të KPK-së i skadon mandati më 15 korrik dhe një tjetri në fund të vitit. Ai shtoi se ka mundësi të ndryshme se si të ruhet kuorumi, për shembull të zgjaten të mandatet e të dy anëtarëve deri në fund të vitit 2015 ose të zgjedhën anëtarë të rinj.

Veprimet pasuese:

- Kosova të sigurojë zbatimin e shpejtë dhe të duhur të katër ligjeve të pakos së gjyqësorit të miratuara së fundmi në mënyrë që ndryshimet të mund të shihen në terren menjëherë sapo ligjet të hyjnë në fuqi (janar 2016);
- KPK të sigurojë që mandati i të gjithë anëtarëve të saj të jetë mbi bazë ligjore adekuate pas skadimit të mandatit të disa prej anëtarëve të tij (dhjetor 2015);

- Kuvendi të sigurojë që të gjithë anëtarët (e mbetur) të KGjK-së të zgjedhen sa më shpejt të jetë e mundur.

(b) Gjyqtarët dhe prokurorët: rekrutimi dhe trajnimet

Z. Enver Peci, Kryesues i Këshillit Gjyqësor, prezantoi të dhëna të përditësuara mbi reformat ligjore dhe kapacitetet institucionale në sistemin gjyqësor. Është miratuar një rregullore për emërimin e gjyqtarëve, e cila përcakton standardet dhe kriteret minimale për këtë qëllim. KGjK gjithashtu ka miratuar një rregullore për provimin me shkrim për rekrutimin e gjyqtarëve, e cila parasheh mbajtjen e një provimi fillestar me shkrim online dhe i cili duhet të kalohet nga kandidatët që përmbushin kriteret e përcaktuara në konkurset për gjyqtarë. Gjithashtu është miratuar një rregullore për administrimin e gjykatave e cila përcakton caktimin e rasteve me short dhe e cila do të kontribuojë në parandalimin e korrupsionit në gjykata. Sa u përket kapaciteteve institucionale, numri i gjyqtarëve në gjykatat themelore ka arritur në 181 (nga gjithsej 192 të paraparë), 31 (nga 40 të paraparë) në Gjykatën e Apelit, dhe 13 (nga 17 të paraparë) në Gjykatën Supreme të Kosovës. Për më tepër, pas marrëveshjes së arritur me Serbinë janë publikuar konkurset për 48 gjyqtarë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (aplikacionet e pranuar aktualisht janë duke u vlerësuar nga KGjK, në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in).

Z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit, raportoi se numri i prokurorëve ka arritur në 137, ndërsa procesi i rekrutimit të 18 prokurorëve të tjerë për prokuroritë themelore është në fazën përfundimtare. Për më tepër, konkurset për 15 prokurorë nga komunitetet jo-shumicë janë publikuar në mars 2015, për të cilat pozita janë pranuar 12 aplikacione dhe procesi i rekrutimit është në proces e sipër (dhe kryhet bashkërisht nga KPK dhe EULEX). Krejt në fund, në proces e sipër janë edhe konkurset e brendshme për gjashtë vende të lira për prokurorë (tre për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe tre për Prokurorinë Speciale).

Z. Paquet mirëpriti trajnimin e detyrueshëm fillestar prej 12 muajsh për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e sapo-rekrutuar dhe faktin që ligji i ri parasheh një vlerësim pas trajnimit. Ai theksoi rëndësinë e sigurimit të cilësisë së trajnimeve dhe vlerësimit transparent dhe objektiv. Gjithashtu u vë në dukje rëndësia që gjatë procesit të hartimit të ligjit mbi Akademinë e Drejtësisë të merren parasysh komentet dhe opinionet e të gjitha palëve të interesuara.

Veprimet pasuese:

- KGjK dhe KPK të përfundojnë proceset në vijim e sipër për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, veçanërisht atyre në Gjykatën Themelore dhe Prokurorinë Themelore të Mitrovicës (dhjetor 2015);
- KGjK dhe KPK të sigurojnë që vlerësimi i performancës së gjykatësve dhe prokurorëve të bëhet rregullisht dhe në mënyrë sistematike duke u bazuar në kriteret e transparencës dhe objektivitetit dhe në përputhje me standardet evropiane dhe standardet e tjera përkatëse; si dhe të sigurohet që trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të jetë i një standardi të lartë);
- Ministria e Drejtësisë të sigurojë konsultime të duhura publike gjatë tërë procesit të hartimit të Ligjit mbi Akademinë e Drejtësisë.

(c) *Të drejtat e njeriut: afatet kohore të strategjisë dhe planit të veprimit; personat me aftësi të kufizuara: përditësimi mbi strategjinë; integrimi i komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas: zotimet e politikave përtej vitit 2015*

Znj. Sadete Demaj nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) raportoi mbi hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut 2016-2020, me qëllim të vendosjes së një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke e lidhur atë me orientimin e përgjithshëm të përpjekjeve dhe përgjegjësiwe institucionale për zbatimin e ligjeve, përfshirë mjetet e mjaftueshme buxhetore për kryerjen e veprimeve. Ky proces është duke u kryer me përfshirjen e shoqërisë civile, si dhe akterëve vendorë e ndërkombëtarë që merren me të drejtat e njeriut. Ajo gjithashtu raportoi që zotimet e reja të politikave për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas (që mbulojnë periudhën 2016-2020) janë në proces të hartimit, i cili kalon nëpër tri faza: konsultimet me autoritetet, shoqërinë civile dhe akterët e tjerë në nivel lokal; hartimi i draftit të parë të dokumentit; dhe konsultimet publike (deri më tani është përfunduar faza e parë). Të dy dokumentet do të finalizohen dhe do t'i dorëzohen Qeverisë për miratim deri në dhjetor 2015. Krejt në fund, gjatë periudhës raportuese ka vazhduar zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 dhe monitorimi i zbatimit të saj. Është hartuar Raporti i Progresit për 2013-2014 mbi zbatimin e saj, i cili përmbledh arritjet dhe sfidat kryesore sipas objektivave të saj.

Z. Paquet përshëndeti miratimin e ligjit për barazi gjinore dhe atij kundër diskriminimit, në maj, si pjesë e pakos së Ligjeve për të Drejtat e Njeriut. Ai nënvizoi rëndësinë e përditësimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut dhe përfshirjen e duhur të shoqërisë civile dhe të gjithë akterëve të tjerë në procesin e hartimit. Ai pyeti për gjendjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe nënvizoi rëndësinë që Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara të jetë plotësisht funksional dhe aktiv.

Z. Paquet theksoi rëndësinë që të merren parasysh kritikët e shprehura nga shoqëria civile rreth zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas dhe duhet të kihet parasysh këto me rastin e hartimit të zotimeve të reja të politikave pas vitit 2015. z. Paquet theksoi se zotimet e politikave janë të besueshme, realiste dhe të matshme. Ai përmendi vizitën e tij te ardhshme në Kosovë në nëntor, për seminarin e 3-të për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas. Ai pret rezultate konkrete mbi fazat finale të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit ekzistues.

Veprimet pasuese:

- ZQM/ZKM të finalizojë dhe Qeveria të miratojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut 2016-2020, duke përfshirë akterët relevantë dhe rekomandimet e tyre; si dhe të sigurohet që strategjia e re të jetë në përputhje me dispozitat e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut (dhjetor 2015);
- Qeveria si dhe institucionet lokale e qendrore të intensifikojnë zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas (dhjetor 2015);
- ZQM/ZKM të përgatisë një vlerësim mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, në funksion të një

seminari të përbashkët me Komisionin Evropian, të planifikuar për 12 nëntor 2015 (tetor 2015);

- ZQM/ZKM të finalizojë dhe Qeveria të miratojë Zotimet e Politikave për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2016-2020, të cilat të jenë të besueshme, realiste e të matshme, dhe të marrin parasysh rekomandimet nga shoqëria civile dhe nga parlamentarët që përfaqësojnë këto tri komunitete, si dhe kontekstin e nivelit lokal (dhjetor 2015);
- ZQM/ZKM të finalizojë dhe Qeveria të miratojë Planin e Veprimit 2016-2020 të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (dhjetor 2015);
- Qeveria të funksionalizojë plotësisht Këshillin Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të sigurojë që ai të luajë rol aktiv dhe kyç në zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit (dhjetor 2015).

(d) Liria e mediave: gjendja më e fundit rreth RTK-së

Znj. Xhevahire Izmaku, anëtare e Komisionit Parlamentar për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, raportoi mbi përpjekjet e vazhdueshme për të rregulluar çështjen e financimit të transmetuesit publik përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës (RTK). Ajo shpjegoi se Komisioni do të vazhdojë me procesin e plotësim-ndryshimit, bazuar në hulumtimet e kryera me OJQ-në Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe një debati publik të mbajtur më 1 korrik 2015. Ajo njoftoi më tej se mandati i pesë anëtarëve të Bordit të RTK-së do të përfundojë më 30 gusht 2015, duke shtuar se konkursi është publikuar dhe Kuvendi ka krijuar një komision *ad hoc* për të kryer procesin e rekrutimit (nga 55 aplikacione të pranuar), gjë që ka çuar në propozimin e listës së anëtarëve të tillë seancës plenare të Kuvendit për emërim përfundimtar.

Z. Paquet theksoi rëndësinë gjithnjë e më të madhe të lirisë së shprehjes dhe të mediave. Ai theksoi se Kosova duhet urgjentisht të gjejë një zgjidhje për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të RTK-së dhe për të garantuar pavarësinë e tij.

Veprimet pasuese:

- Kuvendi i Kosovës të hartojë dhe miratojë Ligjin e plotësuar-ndryshuar për RTK-në, i cili të rregullojë çështjen e financimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm të transmetuesit publik (duke u mbështetur në ekspertizën e financuar nga BE, p.sh. përmes TAIEX-it, nëse është e nevojshme) (dhjetor 2015);
- Kosova të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjate financiare të RTK-së dhe të emërohet një bord kompetent i RTK-së përmes procedurave të drejta dhe transparente (gusht 2015).

(4) Politikat sektoriale

(a) Çështjet e ushqimit dhe veterinarisë: transferimi i inspektorëve nga Komunitet tek AUV-i

Z. Valdet Gjinovci, Kryeshef i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), raportoi se janë nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi me 27 Komuna për të lehtësuar transferimin e inspektorëve të sigurisë së ushqimit dhe atyre të veterinarisë nga Komunitet tek AUV-i. Agjencia gjithashtu ka themeluar zyrat rajonale në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan, dhe i ka dërguar Ministrisë së Financave një kërkesë për

ndarje të buxhetit, e cila, megjithatë, është refuzuar dy herë (arsyeja e dhënë ka qenë mos-qëndrueshmëria). Çështja tani do të adresohet përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit mbi Financimin e Pushtetit Lokal, që do të përfundoj brenda vitit 2015.

Z. Paquet përshëndeti amendamentin e propozuar dhe theksoi se transferimi i inspektorëve nga komunat në AUV ka qenë një çështje e mbetur pezull tashme pesë vite.

Veprimet pasuese:

- Ministria e Financave të plotësojë-ndryshojë Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe Kuvendi të miratojë ligjin e plotësuar-ndryshuar, duke siguruar transferimin e inspektorëve të sigurisë së ushqimit dhe të veterinarisë nga Komunat në AUV (dhjetor 2015);
- AUV të kompletojë transferimin e inspektorët të sigurisë së ushqimit dhe të veterinarisë nga Komunat (dhjetor 2015).

(b) Mjedisi: menaxhimi i mbeturinave dhe master plani

Z. Ferid Agani, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, raportoi mbi gjendjen aktuale lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Ai theksoi se legjislacioni i Kosovës në këtë fushë vazhdimisht është harmonizuar me acquis-në e BE-së, por mbeten sfida në implementim dhe zbatim. Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022 është në fuqi, ndërsa ka filluar hartimi i Master Planit për Menaxhimin e Mbeturinave. Ky plan do të përmirësojë gjendjen aktuale të sistemit të menaxhimit të mbeturinave përmes planifikimit dhe organizimit më të mirë, përmes krijimit të një pasqyre më racionale dhe më të qartë, dhe përmes masave të tjera të nevojshme për t'i dhënë prioritet menaxhimit të mbeturave në të ardhmen.

Z. Cullen tha se politikat mjedisore të Kosovës vazhdimisht janë përballur me fokus të pamjaftueshëm dhe me mungesë të mjeteve buxhetore. Mjedisi duhet të merret parasysh gjatë harmonizimit me politikat e tjera, si energjia, industria ose bujqësia. Menaxhimi i mbeturinave, sipas z. Cullen, është një nga sfidat më të ngutshme dhe të dukshme, dhe se një plan për menaxhimin e mbeturinave duhet të finalizohet menjëherë.

Veprimet pasuese:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të finalizojë dhe Qeveria të miratojë Master Planin për Menaxhimin e Mbeturinave (dhjetor 2015).

(c) Energjia: dekomisionimi dhe termocentrali i ri, si dhe mbrojtja nga rrezatimi

Z. Blerand Stavileci, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, prezantoi mbi gjendjen më të fundit lidhur me dekomisionimin e TC 'Kosova A' dhe ndërtimin e TC 'Kosova e Re'. Grupi punues përgjegjës për dekomisionim (në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 04/156 mbi dekomisionimin dhe çmontimin e azotikut, gazifikimit, ngrohtores dhe objekteve të tjera të cilat nuk e pengojnë funksionimin normal të njërive aktive të 'Kosova A') është duke zbatuar një plan dinamik i cili parasheh përfundimin e dy proceseve në fillim të vitit 2018.

Z. Ferki Fejza, U.D. i Kryeshefit të Agjencisë Kosovare për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore (AKMRrSB), dha një pasqyrë të zhvillimeve më të fundit legjislative e të politikave dhe zbatimin në këtë fushë. Ajo ka hartuar një rregullore mbi

organizimin dhe funksionimin e vet të brendshëm (e cila ende nuk është miratuar nga Qeveria) dhe akte të tjera ligjore, dhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore. Ajo gjithashtu ka krijuar sistemin e kontrollit dozimetrik për personelin që punon me burimet e rrezatimit jonizues (në përputhje me standardet evropiane) dhe ka punuar në drejtim të identifikimit të një lokacioni të përkohshëm për deponimin e mbeturinave radioaktive. Krejt në fund, emërimi i Kryeshefit të saj është në proces e sipër dhe pritet të përfundojë brenda korrikut 2015.

Z. Cullen kërkoi sqarime lidhur me afatet kohore të dekomisionimin e TC 'Kosova A', veçanërisht lidhur me zotimet e bëra me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Ai theksoi se një vendim përfundimtar mbi opsionet në dispozicion për TC 'Kosova A' duhet të merret së shpejti: nëse planifikohet rindërtimi i 'Kosova A', atëherë fondet e IPA-së të ndara duhet të rishpërndahen.

Veprimet pasuese:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) dhe organet e tjera relevante të vazhdojnë me zbatimin e duhur dhe me kohë të planit dinamik 2014-2018 për dekomisionimin e TC 'Kosova A';
- MZhE dhe institucionet tjera relevante të vazhdojnë me përpjekjet e nevojshme për të respektuar Traktatin e Komunitetit të Energjisë, me fokus kryesisht në miratimin e kornizës ligjore, bashkëpunimin rajonal (përfshirë dialogun me Serbinë), dhe implementimin dhe zbatimin (veçanërisht lidhur me dekomisionimin e TC 'Kosova A' dhe ndërtimin e TC 'Kosova e Re');
- AKMRrSB të finalizojë dhe Qeveria të miratojë pesë (5) rregullore për mbrojtje nga rrezatimi dhe për siguri bërthamore, duke siguruar transpozimin e acquis-së relevante (dhjetor 2015);
- AKMRrSB të finalizojë dhe Qeveria të miratojë një plan veprimi që adreson mbetjet e uraniumit të varfëruar (dhjetor 2015);
- Qeveria të përfundojë emërimin e Kryeshefit të AKMRrSB-së dhe të funksionalizojë plotësisht Agjencinë, posaçërisht duke rritur buxhetin e saj (korrik 2015; në vazhdim).

(5) Çështjet Ekonomike

(a) Konkurrenca dhe ndihma shtetërore

Z. Avdyl Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), raportoi mbi zhvillimet e fundit lidhur me funksionimin e Autoritetit. Ai theksoi vështirësitë me të cilat ballafaqohen për shkak të mungesës së objektit të duhur për zyra, numrit të pamjaftueshëm të stafit dhe skadimit të mandatit të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës në fund të prillit 2015. Vështirësi të ngjashme u raportuan lidhur me funksionimin e Zyrës për Ndihmë Shtetërore, edhe pse ajo është themeluar në dhjetor 2013.

Z. Paquet shprehu shqetësimin e tij serioz lidhur me gjendjen në fushën e konkurrencës / ndihmës shtetërore, dhe në veçanti rreth Komisionit Kosovar të Konkurrencës. Ai theksoi urgjencën për emërimin e anëtarëve kompetentë të Komisionit të Konkurrencës, i cili nuk është funksional që nga nëntori 2013, si dhe rëndësinë e objektit të duhur për zyra për punën e AKK-së. Z. Paquet bëri të ditur se Komisioni do të jetë i gatshëm për të ndihmuar me këshilla ligjore/teknike, por vetëm kur AKK të jetë funksionale dhe të ketë objekt adekuat për zyra.

Veprimet pasuese:

- Kuvendi të emërojë anëtarët e Komisionit të Konkurrencës (shtator 2015);
- Qeveria të sigurojë ambiente të përshtatshme të punës për Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës dhe për Zyrën e Ndhmës Shtetërore (shtator 2015);
- Qeveria të ofrojë mbështetjen e nevojshme për të rritur numrin e personelit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës dhe Zyrës së Ndhmës Shtetërore, si dhe të ngritë kapacitetet e tyre, për të siguruar zbatimin e dispozitave të MSA-së në këtë fushë kyçe (shtator 2015).

(b) Prokurimi publik

Z. Safet Hoxha, Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRrPP), raportoi mbi zhvillimet e fundit rreth funksionimit të këtij institucioni. Ai theksoi se procesi në zhvillim e sipër i plotësim-ndryshimit të Ligjit të Prokurimit Publik kërkon harmonizimin e tij me *acquis*-në e BE-së dhe me parimet e përgjithshme të transparencës, mos-diskriminimit dhe konkurrencës së drejtë në prokurim publik. KRrPP gjithashtu ka miratuar gjashtë udhëzime administrative që nga fillimi i vitit 2014. Sa i përket zbatimit, KRrPP ka monitoruar 43 autoritete kontraktuese gjatë vitit 2014 (36 bazuar në planin e veprimit dhe shtatë sipas kërkesës).

Z. Hysni Hoxha, Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP), prezantoi mbi zhvillimet më të fundit legjislative dhe funksionimin e këtij institucioni. Zhvillimet legjislative konsistojnë në Rregulloren e re të Punës së OShP-së (miratuar në maj 2015). Lidhur me zhvillimet institucionale, ai njoftoi se Bordi i OShP-së është i pakompletuar që nga dhjetori 2014, për shkak të skadimit të mandatit të një anëtar (tani funksionon me tre anëtarë). Sa i përket shqyrtimit të ankesave të prokurimit publik, 537 ankesa janë pranuar gjatë vitit 2014: 161 janë kthyer në rivlerësim dhe 104 në ritenderim; për 181 ankesa janë miratuar vendimet e autoriteteve kontraktuese; 40 ankesa janë tërhequr nga ankuesit; 13 janë refuzuar për shkak të mos-kompletimit të dokumentacionit; dy janë konsideruar jashtë kompetencave ligjore të OShP-së; 17 konsiderohen si raste për gjykata; dhe në një rast është nxjerrë një urdher mbi vendimin e OShP-së. Në anën tjetër, deri më 24 qershor 2015 janë pranuar gjithsej 218 ankesa: 190 janë shqyrtuar dhe 28 janë në shqyrtim e sipër. Më konkretisht, nga 218 ankesa, vendimet e autoriteteve kontraktuese janë miratuar për 56 raste; 58 janë kthyer në rivlerësim; 46 në ritenderim; katër janë refuzuar për shkak të dokumentacionit jo të plotë; katër janë konsideruar jashtë kompetencave ligjore të OShP-së; 14 janë tërhequr nga ankuesit; një është konsideruar si rast për gjykatë; dy ankesa lidhur me urdhrin për zbatim të vendimit të OShP-së; pesë ankesa lidhur me vendimet nga Paneli Shqyrtues për vazhdimin e afateve / përmirësimin e kritereve, dhe pjesa e mbetur prej 28 prej tyre janë në shqyrtim e sipër.

Z. Paquet theksoi se prokurimi publik është element kyç për të qenë në gjendje për zhvillimin e duhur të ekonomisë, dhe bëri të qartë se këtë vit raporti për vendin do të analizojë prokurimin publik si një nga kapitujt pilot të cilit do t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Z. Paquet shprehu mirënjohjen për përparimet e arritura në ngritjen e një sistemi të centralizuar të prokurimit publik dhe miratimin e një listë të artikujve të përbashkët në shkurt 2015, por gjithashtu theksoi se autoritetet duhet të fokusohen në zbatimin efikas.

Z. Paquet gjithashtu shprehu shqetësime serioze lidhur me gjendjen rreth emërimeve në institucionet e prokurimit publik (KRrPP dhe OShP) ku emërimi i anëtarëve të bordit duhet të bëhet pa asnjë vonesë. Ai përkujtoi se kjo është thelbësore për të siguruar

profesionalizëm, depolitizim, transparencë dhe llogaridhënie në proceset e PP (përfshirë emërimet në pozita të menaxhmentit të lartë) dhe përsëriti rëndësinë e adresimit të çështjes së preferencës për produktet vendore, marrë parasysh detyrimet e MSA-së.

Veprimet pasuese:

- Kuvendi të përfundojë emërimin e anëtarëve të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (shtator 2015);
- Ministria e Financave të finalizojë dhe Kuvendi të miratojë Ligjin e plotësuar-ndryshuar për Prokurim Publik, duke siguruar pajtueshmëri me acquis-në e BE-së dhe me dispozitat e MSA-së, si dhe parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së drejtë (dhjetor 2015).

(c) Programi i Reformave Ekonomike: Këshilli Fiskal dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

Z. Avdullah Hoti, Ministër i Financave, përqendroi diskutimin e tij në gjendjen aktuale lidhur me hartimin e Programit të Reformave Ekonomike (PRE) dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, dhe në përpjekjet për të përmirësuar qëndrueshmërinë buxhetore e fiskale, si dhe synimin për të krijuar një Këshilli Kombëtar për Investime.

Z. Paquet rikujtoi konkluzionet ECOFIN-it të datës 12 maj 2015, përmes të cilave u mirëprit dorëzimi i PRE-së së Kosovës dhe u cilësua si hap i parë drejt vendosjes së dialogut ekonomik me BE-në. Ai nënvizoi rëndësinë që Kosova menjëherë të ndërmarrë masa pasuese në përmbushjen e rekomandimeve të ECOFIN-it (si dhe të konkluzioneve të punëtorisë së përbashkët me Bankën Botërore, të mbajtur në Prizren) dhe bëri të ditur se PRE i ardhshëm, i vitit 2016, dhe se në kuadër të takimeve sektoriale të DPSA-së – nën-komisioneve të ardhshme të MSA-së – do të trajtohet monitorimi i tij, do të ketë diskutime dhe do të sigurohet ndërmarrja e veprimeve pasuese. Z. Paquet në mënyrë të veçantë përmendi rekomandimet 1 dhe 6, të cilat synojnë të ndihmojnë në ruajtjen e qëndrueshmërisë së financave publike, sigurimin e transparencës dhe efikasitetit të shpenzimeve së vendimeve që kanë ndikim të madh në buxhet, dhe në mbështetjen e koordinimit më të mirë ndërmjet organeve qeveritare dhe atyre parlamentare të cilat janë përgjegjëse për proceset buxhetore.

Veprimet pasuese:

- Në kuadër të Këshillit Kombëtar për Investime duhet të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia e aspekteve fiskale dhe buxhetore të investimeve publike (dhjetor 2015);
- Qeveria të sigurojë ruajtjen e qëndrueshmërisë afatmesme buxhetore, në përputhje me kufizimet fiskale.

(d) Kapacitetet administrative: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

Z. Avni Kastrati, Zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, prezantoi mbi zhvillimet më të fundit rreth ngritjes së kapaciteteve të kësaj ministrie, me fokus në funksionalizimin e plotë të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë dhe emërimin e disa pozitave kyçe të menaxhmentit (kryesisht udhëheqës të departamenteve).

Z. Isa Krasniqi, Kryeshef i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, raportoi kryesisht mbi zhvillimet rreth ngritjes së kapaciteteve të Agjencisë dhe përgatitjeve për regjistrimin e pjesshëm të popullsisë dhe ekonomive familjare në katër komunat në veri të Ibrit të cilat nuk janë mbuluar nga regjistrimi zyrtar i vitit 2011. Riorganizimi ASK-së ka rezultuar në krijimin e tri departamenteve (Departamentit për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim; Departamentit për Sondazhev dhe Regjistrime; dhe Departamentit të Statistikave Sociale). Në anën tjetër, një kërkesë për fonde të BE-së për regjistrimin e pjesshëm të popullsisë dhe ekonomive familjare (planifikuar të kryhet në prill 2016) është dorëzuar, gjë që do të pasohet me hartimin e një ligji të veçantë.

Z. Paquet rikujtoi se kapacitetet adekuate administrative janë thelbësore për administrimin efikas dhe për zbatimin e politikave qeveritare. BE u ka ofruar mbështetje të konsiderueshme institucioneve të ndryshme qeveritare gjatë viteve dhe pret që kapacitetet e krijuara e puna e mirë në përgatitjen e Ministrisë për negociata të MSA-së të ruhen dhe se çfarëdo ndryshimi të bazohet në praktikën e mira të administratës publike. Kjo çështje është edhe më e rëndësishme marrë parasysh se reforma e administratës publike (RAP) është sektor i mundshëm i pilotimit për mbështetje sektoriale me buxhet dhe garancitë e marra nga qeveria në këtë drejtim.

Veprimet pasuese:

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të sigurojë mirëmbajtjen dhe pavarësinë e shërbimit civil dhe qëndrueshmërinë e mbështetjes së marrë nga BE në këtë drejtim; të përfundojë procesin në vazhdim e sipër të rekrutimit për pozita menaxhuese, në përputhje me standardet e mira të RAP-it, dhe të vazhdojë forcimin e kapaciteteve të saj institucionale në mënyrë që të sigurojë zbatimin e legjislacionit dhe dispozitave të MSA-së, përfshirë kapacitetet e Agjencisë së Metrologjisë dhe të laboratorëve teknikë (dhjetor 2015);
- Qeveria të finalizojë dhe Kuvendi të miratojë Ligjin e plotësuar-ndryshuar për Statistika Zyrtare, në përputhje me rekomandimet e EUROSTAT-it dhe të sigurojë forcimin e menaxhmentit të ASK-së (dhjetor 2015);
- Qeveria të marrë në konsideratë mundësinë që ASK-së t'i mundësojë rekrutimin e stafit të ri profesional të nevojshëm për themelimin e Departamentit të Statistikave të Llogarive Kombëtare brenda ASK-së, si dhe për forcimin e kapaciteteve të TI-së (dhjetor 2015);
- Qeveria të përfundojë përgatitjet për regjistrimin e pjesshëm të popullsisë dhe ekonomive familjare në katër komunat që nuk janë mbuluar nga regjistrimi zyrtar i vitit 2011, përfshirë ndarjen e fondeve të nevojshme (dhjetor 2015).

(6) Vërejtjet përmbyllëse

Konkluzionet e takimeve sektoriale u miratuan zyrtarisht.

Pasi që pritet hyrja në fuqi e MSA-së në fillim të vitit 2016, ky ishte Takimi i fundit Plenar i DPSA-së. Palët do të mblidhet në një format ekuivalent vitin e ardhshëm në kuadër të Këshillit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE – Kosovë. Palët do të dakordohen mbi datën e këtij takimi në kohën e duhur.